

VENDIM
Nr. 449, datë 22.7.2021

PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES DHE TË KATEGORIVE, QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, “TREGIME TË MOÇME SHQIPTARE” DHE REVISTA LETRARE “LETRA NGA DIASPORA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ndryshuar, të shkronjës “gj”, të nenit 21, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikave 10, shkronja “dh”, e 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes të teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, botimi dygjuhësh “Tregime të moçme shqiptare” dhe revista letrare “Letra nga diaspora”, sipas listës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit e të mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

2. Kategoritë, që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.

3. Botimi dygjuhësh “Tregime të moçme shqiptare” dhe revista letrare “Letra nga diaspora”, të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni.

4. Çmimi i teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve të Diasporës “Tregime të moçme shqiptare” dhe “Letra nga diaspora” vendoset në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, ku përfshihen botimi, ambalazhimi dhe shpërndarja, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2021.

6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA NR. 1

I. Çmimi në kopertinë prej 1000 (një mijë) lekësh, sipas tirazhit përkatës, për botimin dygjuhësh “Tregime të moçme shqiptare”, me autor Mitrush Kutelin, në 5 (pesë) gjuhë:

- | | |
|---|-------------|
| 1. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip–anglisht) | 1 000 copë; |
| 2. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip–italisht) | 1 000 copë; |
| 3. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip–greqisht) | 1 000 copë; |
| 4. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip–gjermanisht) | 1 000 copë; |
| 5. “Tregime të moçme shqiptare” (shqip–frëngjisht) | 1 000 copë. |

II. Çmimi në kopertinë prej 1 200 (një mijë e dyqind) lekësh, sipas tirazhit përkatës, për revistën letrare “Letra nga diaspora” në 2 (dy) gjuhë:

1. “Letra nga diaspora” (shqip) 300 copë;
2. “Letra nga diaspora” (anglisht) 300 copë.